**VENDIM**
**Nr. 276, datë 6.4.2020**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS ME OBJEKT "BLERJE MATERIALE MJEKËSORE NË KUADËR TË MASAVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT COVID-19"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës me objekt "Blerje materiale mjekësore në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19", me palë Ministrinë e Drejtësisë dhe operatorin ekonomik "FEDOS", sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**